



KUSHTET DHE TERMET E PËRGJITHSHME TË LICENCËS SË KPM-SË
PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE
PËR
TRANSMETIM PËRMES OPERATORËVE TË SHPËRNDARJES

1.0 Përkufizime:

- 1.1 KPM:** Me Komision të Pavarur për Media kuptojmë institucioni e themeluar nga Kuvendi i Kosovës i cili vepron në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejme Ligji i KPM-së).
- 1.2 Rregulloret e Komisionit të Pavarur për Media (KPM):** Me Rregullore të KPM-së kuptojmë aktet nënligjore të miratuar nga Komisioni i Pavarur për Media përmes të cilave përcaktohen të drejtat dhe detyrat e subjekteve të licencura për transmetim në Republikën e Kosovës.
- 1.3 Ofrues i shërbimit medial** – Ofrues i shërbimit medial – personi fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audio vizuale të ofruesit të shërbimit medial dhe që përcakton mënyrën e organizimit të tij.
- 1.4 Shërbimi medial audio-vizuel** - shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.
- 1.5 Operatori i shpërndarjes** – personi juridik i cili shpërndan shërbime mediale audio dhe audio-vizuale për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV, OTT, satelitor dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv tokësor.
- 1.6 Shpërndarje** – ofrimi i shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale përmes operatorëve të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur (me apo pa tel) shpërndajnë përmbajtje audio dhe vizuale deri tek përdoruesit.

- 1.7 Program** - një pako e fotografive lëvizëse me ose pa zë që përbën një njësi të vetme brenda orarit ose katalogjeve të programeve të vendosura nga ofruesi i shërbimit medial, forma e të cilit është e krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filmat e metrazhit të gjatë, ngjarjet sportive, komeditë, dokumentarët, programet për fëmijë dhe dramat origjinale.
- 1.8 Përgjegjësia redaktuese** – ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe mjeteve për ushtrimin e kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen dhe organizimin e tyre në radhitje kronologjike në rastin e transmetimit televiziv, ose në katalog në rastin e shërbimit medial audiovizual në bazë të kërkesës.
- 1.9 Licencë** – leja e dhënë nga KPM-ja për ofruesit e shërbimeve mediale për të ushtruar aktivitetet të ofrimit të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.
- 1.10 Dhënia e Licencës** - Në pajtim me Ligjin për KPM-në dhe Kreun III të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.
- 1.11 I Licencuari** -Person juridik të cilit KPM-ja i ka dhënë licencë për transmetim të programeve radiotelevizive përmesë operatorit të Shpërndarjes.
- 1.12 Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës:** Me Kushte dhe Terme të Përgjithshme të Licencës kuptojmë të drejtat dhe detyrimet e të licencuarit, të zbatueshme për të gjithë ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes sistemit të operatorit të shpërndarjes.
- 1.13 Format i Programit të Licencuar:** Me Format të Programit të Licencuar kuptojmë përbërësit e programit të të licencuarit siç specifikohet në Pjesën 3 të Licencës.
- 1.14 Kohëzgjatja e Licencës:** Licenca për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio - Radio do të jetë e vlefshme 7 vite, ndërsa, për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale -TV do të jetë e vlefshme 10 vite, me mundësi të vazhdimit ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për KPM-në..

2.0 Pajtueshmëria:

- 2.1 Natyra e Licencës:** Dhënia e kësaj licence përbënë një kontratë të detyrueshme për të licencuarin që të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, me kushtet dhe termet e përgjithshme të Licencës së KPM-së, dhe me të gjitha rregulloret e nxjerra nga Komisioni i Pavarur për Media, apo nga ndonjë organ kompetent ligjor tjetër në Kosovë, përveç rasteve kur i licencuari përjashtohet veçanërisht nga KPM me shkrim nga dispozita të tilla.

2.2 Vlefshmëria e Licencës: Vlefshmëria e kësaj licence bëhet e mundshme kur veprohet në përputhje me kushtet dhe termet e saj si dhe me dokumentet tjera ligjore të cituar në nenin 2.1 të kushteve dhe termeve të licencës. Shkeljet e rënda të kësaj licence, përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në ato, transferimin e paautorizuar të pronësisë ose të kontrollit të licencës. Shkelje të tilla mund të çojnë në anulim të licencës.

2.3 Përputhja me urdhëratë: I licencuari duhet të veprojë në përputhje me të gjitha urdhrat dhe udhëzimet e ligjshme të dhëna nga KPM për të vënë në zbatim rregulloret për transmetim të programeve audio dh audiovizuele, përmes operatorit të shpërndarjes.

2.4 Hyrja në ndërtesa: I licencuari obligohet të lejojë çdo person, të autorizuar me shkrim nga KPM, të hyjë në ndërtesat që i licencuari i shfrytëzon për transmetim, prodhim programesh ose si zyrë, me qëllim të inspektimit për të verifikuar pajtueshmërinë me kërkesat rregullative të ligjshme të KPM-së.

2.5 Përputhja me rregulloret e KPM-së: I licencuari mban përgjegjësi për të vepruar në përputhje me të gjitha rregulloret e nxjerra nga KPM, përsa i përket të gjitha programeve që ai mund të transmetojë, pavarësisht nga burimi origjinal i një programi të tillë.

2.6 Mundësia për përgjigje: Në rast të ndonjë shkeljeje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të licencës së KPM-së, ose të rregulloreve në pajtueshmëri me ligjet e zbatueshme në Kosovë, KPM do të sigurojë plotësisht dhe në mënyrë të paanshme mundësinë për t'iu dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve për shkeljet.

2.7 Fondet publike: I Licencuari që merr fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ose nga të tjera taksa publike të detyruara që zbatohen në Kosovë duhet që çdo vit të përgatisë një raport financiar publik për përdorimin e këtyre fondeve, dhe duhet t'i nënshtrohet kontrollit dhe revizionit të KPM-së.

2.8 Kësaj licence i bashkëngjiten për referim ligjor të gjitha dokumentet ligjore të nxjerra nga KPM.

3.0 Dispozita për Veprimtarinë

3.1 Detyrimet për të Drejtën e Autorit:

3.1.1 Të licencuarit i kërkohet të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta si dhe ligjet tjera të zbatueshme në Kosovë për pronësinë intelektuale, dhe në veçanti të sigurojë leje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjithë programeve komerciale. Këtu përfshihet

3/8

riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që rrjedhin nga sateliti. Në rastin kur programi konsiderohet i zotërimit publik, nuk kërkohet një leje e tillë.

3.1.2 I licencuari obligohet që t'i sigurojë KPM-së kopjet e marrëveshjeve për këto leje brenda tri (3) ditëve nga kërkesa me shkrim.

4.0 Mbajtja e Arkivës:

4.1 I licencuari duhet të mbajë arkivë 21 ditëshe të të gjitha programeve të transmetuara audio dhe audiovizuale, në format digjital ekuivalent.

4.2 Informacionet të cilat i Licencuari obligohet t'i ofrojë KPM-së:

4.2.1 I licencuari duhet, që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, të informojë KPM-në për ndryshimet në të dhënat e mëposhtme, dhe të gjitha këto do të trajtohen nga KPM-ja si çështje të dhënash publike:

- (a) Çdo ndryshim në gjendjen e individëve, zyrtarëve të OJQ-ve ose pronarëve të kompanive që kanë Licencë të KPM-së ose pronësi të një pjese të saj që mund të çojë në skualifikimin e tyre për marrjen e licencës duhet t'i raportohet KPM-së brenda pesë (5) ditëve të punës nga ndryshimi i gjendjes. Një individ i skualifikuar mund të shkëputet vetë nga i licencuari brenda 30 ditëve nga koha kur u bë për skualifikim, përveç rastit kur KPM-ja lejon një periudhë më të gjatë për të bërë rregullimin. KPM-ja do të kërkojë në këto raste të minimizojë rrezikun e çrregullimit të operimit të emetuesit.
- (b) Të dhënat e adresës së Stacionit, telefoni, faksi ose informacione të tjera kontakti;
- (c) Menaxhmentin Kryesor (Zyrtarët e lartë), përfshirë drejtorin e përgjithshëm, drejtorin e programeve dhe drejtorin teknik;
- (d) Identiteti i pronarëve të radhitur në kërkesën për licencë që zotërojnë më pak se 10% të aksioneve të një emetuesi që është regjistruar si shoqëri aksionare (Ndryshimet me 10% e lart kërkojnë miratim paraprak të KPM-së në përputhje me paragrafin 5.2 të Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Ofruesit e shërbimeve mediale përmes operatorit të shpërndarjes);
- (e) Identiteti i drejtorëve të OJQ-së që themelon një të Licencuar;
- (f) Ndryshime të mëdha në orët e operimit;
- (g) Ndërprerje të transmetimit më të gjata se programi i planifikuar i një dite të plotë.

4.3 Koha e transmetimit: Të licencuarit i lejohet transmetimi 24 orë në ditë, në të shtatë ditët e javës, përveç rasteve kur kufizohet nga Kushtet dhe Termet Specifike të Licencës.

4.4 Identifikimi i ofruesit të shërbimit medial audiovizuel:

4.4.1 I licencuari që ofron radio program duhet ta identifikojë veten gjatë emetimit qartë dhe në vazhdimësi me anë të emrit të tij të autorizuar së paku një herë në çdo 60 minuta transmetimi.

4.4.2 I licencuari që ofron programe televizive duhet ta identifikojë veten gjatë emetimit qartë dhe në vazhdimësi me anë të emrit të tij të autorizuar së paku një herë në çdo 60 minuta transmetimi, dhe duhet të mbajë një shenjë të veçantë identifikimi në ekran gjatë gjithë programit, me përjashtim të komunikimeve komerciale.

4.4.3 I licencuari që ritransmeton programe të prodhuara nga organizata të tjera emetuese duhet që të identifikojë qartë dhe në vazhdimësi burimin e programit të ritransmetuar.

4.5 Praktikrat e mbrojtjes së shëndetit:

4.5.1 I licencuari duhet t'i vërë në funksionim të gjitha sistemet dhe objektet e transmetimit përta i përket mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve dhe të publikut në përgjithësi, në përputhje me ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

4.5.2 Strukturat e pajisjeve teknike duhet të jenë konform standardeve të përgjithshme Evropiane të pranuar për sigurinë e konstruksionit dhe të mirëmbajtjes, përfshirë përdorimin e dritave që duhen për sinjalizimin e mjeteve fluturuese, në përputhje me ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

4.5.3 I licencuari në përshtatje me porositë dhe njoftimet për përdorim të përgjithshëm që mund të nxjerrë KPM-ja për të siguruar informimin e publikut për licencën e tij, ankesat me shkrim, pronësinë ose dokumenta të tjera që lidhen me veprimtarinë e stacionit, që KPM-ja mund konsideroj se janë me interes publik.

4.6 Ndërprerjet e Transmetimit: Ndërprerjet e shpeshta dhe të zgjatura të transmetimit në veprimtarinë e ofrimit të shërbimit të programeve përmes operatorit të shpërndarjes, do të bëjnë që nga ana e KPM-së të rishikohen rrethanat dhe mund të çojnë në anulimin e Licencës.

4.7 Pagesa për Licencën: Për marrjen e licencës, i licencuari duhet të paguaj një pagesë për tarifën vjetore të licencës në bazë të rregullores KPM-2017/03.

4.8 Formati i Programit:

4.8.1 Në bazë të Nenit 9 të Ligjit të KPM-së, KPM merr parasysh standardet e pranuar ndërkombtarisht të transmetimit dhe të drejtave të njeriut në dhënien e licencave të transmetimit, duke respektuar plotësisht demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Nga i licencuari pritet që në transmetimet e veta, si një nga kushtet e licencës, t'i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit i është dhënë licenca. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me kushtet dhe termet e licencës mund të çojë deri në anulimin e saj.

4.8.2 Nga i licencuari kërkohet që të njoftojë KPM-në paraprakisht me propozimin për ndryshime të mëdha të tipit, të burimit të programeve të dhëna në Pjesën 3 të licencës ose të propozimit të heqjes së një përbërësi të formatit të programit të licencuar.

5.0 Përdorimi dhe Transferimi i Licencës:

5.1 Karakteri i Licencës: Kjo licencë është një dhënie e kushtëzuar e lejes nga ana e KPM-së për të ofruar shërbime të programeve audio dhe audiovizuale, përmes operatorit të shpërndarjes.

5.2 Transferimi ose Dorëzimi i Licencës: I licencuari nuk mund të transferojë ose dorëzojë këtë licencë pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së. Çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që ndikojnë shumë në kontrollin e të licencuarit do të kërkojnë paraprakisht miratim me shkrim nga ana e KPM-së.

5.3 Leja për transferimin: KPM do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që individit ose organizatës të cilët propozohen që t'iu transferohet licenca plotësohen standardet e KPM-së për t'iu dhënë ajo licencë. Në bazë të mandatit të saj, KPM mund të kërkojë që çdo transferim i një licence tek një pronësi e re t'i nënshtrohet procedurave të rregullta për të siguruar që një transferim i tillë është në pajtueshmëri me të gjitha rregulloret e KPM-së.

6.0 Sanksionet për mosrespektimin e Licencës dhe Rregulloret të KPM-së:

6.1 Sanksionet e zbatueshme: Shkelja e kushteve dhe termeve të kësaj Licence ose dokumenteve ligjore që e shoqërojnë atë mund të çojnë në një ose më shumë nga sanksionet e mëposhtme të specifikuar në Nenin 30 të Ligjit të KPM-së:

- (a) t'i urdhërojë të licencuarit që t'i transmetojë publikisht detajet e natyrës dhe shkallës së shkeljes së kushteve të licencës dhe rregulloreve tjera në pajtueshmëri me ligjin e KPM-së;
- (b) të kërkojë nga i licencuari që të transmetojë korrigjimin ose të kërkojë falje përmes transmetimit;
- (c) t'i vendosë një gjobë në vlerë jo më pak se 1,000.00 euro dhe jo më shumë se 100,000.00 euro;
- (d) të kërkojë pezullimin e një pjese ose gjithë orarin e programit të ofruesit të shërbimeve programore për një periudhë të saktësuar kohe;
- (e) t'ia ndryshojë kushtet e licencës së ofruesit të shërbimeve programore;
- (f) t'ia ndërpresë apo refuzojë vazhdimin e licencës së ofruesit të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes operatorit të shpërndarjes.

7.0 Pezullimi apo Anulimi i Licencës:

- 7.1 Në rastin kur KPM-ja jep sanksionin sipas nenit 6.1 (d), (e) dhe (f) kundër të Licencuarit duke kërkuar pezullimin e transmetimit anulimin e autorizimit për transmetim të të Licencuarit, përveç rasteve kur është shpallur gjendje e jashtëzakonshme nga autoritetet e autorizuar me Ligj për të deklaruar gjendje të jashtëzakonshme, sanksioni nuk do të jetë në veprim deri sa Bordi i Ankesave për Media të jep përcaktimin përfundimtar. Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, i Licencuari i urdhëruar që të pezullojë ofrimin e shërbimeve të programit duhet ta zbatojë këtë gjë menjëherë pas marrjes së një urdhëri të tillë nga KPM-ja. Mos vënia në zbatim e tij mund të çojë në anulimin e licencës.
- 7.2 I licencuari merr njoftim dhe pranon që shkelja e kushteve dhe termeve të kësaj licence, dhe mosrespektimi i rregulloreve të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, iu nënshtrohet sanksioneve të parapara në nenin 30 të Ligjit të KPM-së, duke përfshirë edhe anulimin e licencës, nëse këto shkelje konsiderohen kundërvajtje të rënda të kësaj marrëveshjeje për licencën.

8.0 Forca Madhore:

8.1 Marrja në konsideratë e Forcës madhore: Në vlerësimin e neglizhimit të të licencuarit për të vepruar sipas kushteve dhe termeve të licencës së tij, KPM do të merr parasysh të gjitha rrethanat e rënda dhe të pakontrollueshme nga një *forcë madhore*, siç janë nxjerrja jashtë nga objektet, zjarri, eksplozimi ose trazira sociale.

8.2 Mos-zbatimi i tarifave të licencës: Rrethanat e radhitura në nenin 8.1 të kushteve dhe termeve të Licencës së KPM-së për Ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes operatorit të

shpërndarjes, nuk do të përdoren për të justifikuar pezullimin pagesave të licencës që duhen paguar. Gjithashtu, avaritë e vogla të pajisjeve që nuk ndikojnë në pengimin e funksionimit të të licencuarit nuk do të interpretohen si *forcë madhore*.

9.0 Amandamenti i licencës:

9.1 Përveç dispozitave për transferimin e pronësisë i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshime në licencë duke ia bërë me shkrim KPM-së kërkesën për ato ndryshime.

Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pas miratimit paraprak me shkrim nga ana e KPM-së.

9.2 Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e licencës së të Licencuarit, me një procedurë të përcaktuar në përputhje me Ligjin e KPM-së, duke u siguruar që këto ndryshime do të jenë shumë të nevojshme për zbatim më efikas të licencës. I Licencuari, në mënyrë të arsyeshme, do të ketë mundësi që të bëjë paraqitjen para KPM-së, për sa i përket ndryshimeve të propozuara nga ana e KPM-së.

Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë, i Licencuari pranon dhe bie dakort me të gjitha kushtet dhe termat e përcaktuara të kësaj Licence, përfshirë edhe respektimin e të gjitha rregulloreve të nxjerra nga KPM.

Për të Licencuarin:

EMRI: _____

DATA: _____

NËNSHKRIMI: _____

Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë nga ana e KPM-së, kjo licencë do të konsiderohet si e dhënë zyrtarisht dhe e vlefshme.

EMRI: _____

DATA: _____

Adnan MEROVCI
Kryetar i KPM-së

NËNSHKRIMI: _____

vula: